

VENDIM
Nr. 32, datë 30.5.2023

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Marsida Xhaferllari	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, më datë 29.5.2023 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 1 (GJ) 2023 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: shfuqizimi i nenit 11, pika 4, të ligjit nr. 9754, datë 14.6.2007, “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë”, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: nenet 131, pika 1, shkronja “a”, 134, pika 1, shkronja “dh” dhe 145, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 68 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim parashtimet me shkrim të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm (*gjykata referuese*), e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Kuvendit të Shqipërisë (*Kuvendi*), Këshillit të Ministrave dhe Prokurorisë së Përgjithshme, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në vitin 2019 ka dërguar në gjyq çështjen penale ndaj tre të pandehurve, njëri prej të cilëve ishte person juridik. Ky i fundit është akuzuar për veprat penale “Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë” dhe “Dhënia e ndihmës për ndërtim të paligjshëm”, të parashikuara respektivisht nga nenet 289, paragrafi 1 dhe 199/b të Kodit Penal (KP).

2. Në përfundim të gjykimit të shkurtuar të çështjes, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 2485, datë 5.11.2020, ka vendosur, ndër të tjera, deklarin fajtor të personit juridik sipas akuzave dhe dënimin e tij përfundimisht me 4,000,000 lekë gjobë, pas zbritjes me 1/3-ën sipas nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale (KPP). Në caktimin e llojit dhe masës së dënimit penal për personin juridik, gjykata i është referuar nenit 11, pika 4, shkronjat “b” dhe “c”, të ligjit nr. 9754,

datë 14.6.2007 “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë” (ligji nr. 9754/2007), të lidhur respektivisht me dënimin e parashikuar për veprat penale nga nenet 289, paragrafi 1 dhe 199/b të KP-së.

3. Kundër vendimit kanë ushtruar ankim dy prej të pandehurve, midis të cilëve edhe personi juridik, duke kundërshtuar masën e dënimit me gjobë, me pretendimin se çdo dyshim shkon në favor të të pandehurit dhe duhej të zbatohet parimi i ligjit penal favorizues. Sipas personit juridik, masa e dënimit me gjobë ndaj tij për veprën penale “Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë”, të parashikuar nga neni 289, paragrafi 1, i KP-së, duhej caktuar bazuar në shkronjën “c” të pikës 4 të nenit 11 të ligjit nr. 9754/2007, dhe jo në shkronjën “b”, sikurse e ka zbatuar gjykata e shkallës së parë.

4. Gjatë gjykimit në shkallën e dytë, gjykata referuese, në seancën gjyqësore të datës 26.10.2022, pasi dëgjoi kërkesat paraprake të palëve, bazuar në nenin 145, pika 2, të Kushtetutës dhe nenin 112 të KPP-së, ka vendosur pezullimin e gjykimit dhe dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata), për të vlerësuar kushtetutshmërinë e pikës 4 të nenit 11 të ligjit nr. 9754/2007 (*dispozita e kundërshtuar*). Kjo dispozitë parashikon: “Në varësi të llojit të veprës penale zbatohen dënimet me gjobë, si më poshtë: a) për krimet që, sipas Kodit Penal, parashikohet një dënim, minimumi, jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet burgim ose burgim i përjetshëm, personi juridik dënohet me gjobë nga 25 milionë lekë deri në 50 milionë lekë; b) për krime që, sipas Kodit Penal, parashikohet një dënim, minimumi, jo më pak se shtatë vjet deri në pesëmbëdhjetë vjet burgim, personi juridik dënohet me gjobë nga 5 milionë lekë deri në 25 milionë lekë; c) për krime që, sipas Kodit Penal, parashikohet një dënim, maksimumi, më pak se shtatë vjet, personi juridik dënohet me gjobë nga 500 mijë lekë deri në 5 milionë lekë.”.

5. Kolegji i Gjykatës, më datë 2.3.2023, bazuar në nenin 21, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

6. Gjykata referuese e ka paraqitur kërkesën nën emërtimin “Gjykata e Apelit Tiranë”. Pas paraqitjes së kërkesës, me vendimin nr. 505, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”, prej datës 1.2.2023 kërkesja është riorganizuar dhe ka filluar të funksionojë nën emërtimin e ri, ndaj Gjykata në tekstin e këtij vendimi do t’i referohet asaj me emërtimin “Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

7. **Gjykata referuese**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se dispozita e kundërshtuar ka cenuar:

7.1 *Të drejtën e mosdënimit pa ligj*, të garantuar nga neni 29 i Kushtetutës dhe neni 7 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), pasi mënyra e hartimit të klasifikimeve të dënimit me gjobë për personat juridikë është i pasaktë. Marzhi i dënimit i parashikuar për veprën penale të shkeljes së rregullave të mbrojtjes në punë nga neni 289, paragrafi 1, i KP-së nuk mund të klasifikohet as në shkronjën “b”, as në shkronjën “c” të nenit 11, pika 4, të ligjit nr. 9754/2007. Kjo mund të konsiderohet edhe si ometim i normës juridike, që passjell edhe cenimin e parimit të proporcionalitetit, të garantuar nga neni 17 i Kushtetutës.

7.2 *Parimin e barazisë para ligjit*, të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi norma ligjore nuk është e qartë dhe ekspozon ndaj dënimit të konsiderueshëm me gjobë personin juridik për veprën penale të dënueshme deri në 10 vjet burgim sipas nenit 289, paragrafi 1, të KP-së, duke e barazuar me rastin e veprave penale të rrezikshme, për të cilat KP-ja parashikon dënim me burgim nga 7 deri në 35 vjet.

7.3 *Parimin e drejtësisë, ligjshmërisë dhe sigurisë juridike*, të garantuar nga neni 4 i Kushtetutës, pasi parashikimi i dënimit penal në ligj është i paqartë.

7.4 Të drejtën e pronës private dhe lirinë e veprimtarisë ekonomike, të garantuara respektivisht nga nenet 41 dhe 11 të Kushtetutës, pasi përcaktimi i kufijve të dënimit me gjobë shoqërohet me pasoja domethënëse financiare dhe ekonomike për personin juridik dhe aktivitetin e tij.

8. **Subjekti i interesuar, Kuvendi**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se:

8.1 Gjykata referuese *nuk legjitimohet*, pasi gjykimi që ajo po zhvillon mund të zgjidhet duke zbatuar nenet 34 dhe 45 të KP-së. Po kështu, ajo nuk ka konsideruar praktikën gjyqësore shqiptare që nga viti 2007. Normat e tjera të KP-së të referuara në përmbajtje të kërkesës nuk janë të zbatueshme në gjykimin pranë saj, ndaj gjykata referuese nuk pengohet nga mënyra e hartimit të ligjit për veprat e tjera penale të KP-së. Argumentet në kërkesë nuk janë në nivel kushtetues, pasi lidhen me interpretimin e ligjit, që është detyrë e vetë gjykatës së apelit dhe në vijim e Gjykatës së Lartë, që siguron njësimin e praktikës gjyqësore.

8.2 Pretendimet për *cenimin e parimeve të ligjshmërisë dhe mosdënimit pa ligj* janë të paqarta dhe të paargumentuara. Përgjegjësia e penale e personave juridikë parashikohet nga neni 45 i KP-së, ndërsa parimet, llojet e përgjegjësive, llojet dhe masat e dënimit janë të përcaktuara në ligjin nr. 9754/2007. Të dyja këto ligje janë miratuar me shumicë të cilësuar.

8.3 Dispozita e kundërshtuar nuk cenon parimet kushtetuese të *barazisë ligjore dhe proporcionalitetit të dënimit*. Gjykata referuese nuk ka sqaruar se si, pse dhe midis kujt cenohet barazia ose se si persona që gjenden në kushte të njëjta do të kenë trajtim të pabarabartë bazuar në shkaqet e nenit 18 të Kushtetutës nga zbatimi i dënimeve të përcaktuara nga ligji nr. 9754/2007. Dënimi me gjobë është më i përshtatshmi për parandalimin e kriminalitetit të personave juridikë, i cili parashikohet si zëvendësim i dënimit me burgim të zbatuar ndaj personave fizikë për vepra të veçanta penale dhe barazohet me të.

8.4 Pretendimi për *cenimin e parimit të sigurisë juridike* është i pabazuar. Dispozita është e qartë, i përfshin të gjitha kategoritë e veprave penale dhe nuk lë vend për antikushtetutshmëri. Formulimi i saj, i ndryshëm nga ai i KP-së, nuk është shkak antikushtetutshmërie. Sipas ligjit nr. 9754/2007, minimumi dhe maksimumi i dënimit marrin një kuptim tjetër nga KP-ja. Ligji është interpretuar nga gjykatat që nga viti 2007 dhe nuk ka pasur asnjë problem paqartësie.

9. **Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se:

9.1 Gjykata referuese *nuk legjitimohet*, pasi nuk është identifikuar saktë cila prej shkronjave të pikës 4 të nenit 11 të ligjit nr. 9754/2007 është antikushtetuese, në kushtet kur jo të gjitha zgjidhin gjykimin pranë saj. Ajo nuk ka bërë interpretim shterues të dispozitës dhe nuk ka analizuar se përse gjykimi nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga gjykimi kushtetues. Gjykata referuese nuk ka bërë të gjitha përpjekjet për interpretimin qëllimor të normës dhe nuk ka parashtruar argumente serioze për antikushtetutshmërinë, por e ka paragjykuar normën duke e interpretuar literalisht. Ajo është shprehur hipotetikisht për raste teorike, duke tejkaluar lidhjen e drejtpërdrejtë midis çështjes kushtetuese dhe gjykimit pranë saj.

9.2 Pretendimi për *cenimin e parimit të barazisë para ligjit* është i pabazuar. Dispozita e kundërshtuar është e zbatueshme për të gjithë personat juridikë që kryejnë një vepër penale, pa cenuar ndonjë prej tyre për shkaqet e parashikuara në nenin 18 të Kushtetutës. Masa e gjobës përcaktohet vetëm bazuar në llojin dhe veprën penale konkrete të kryer. Ajo nuk passjell trajtim të njëjtë për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme dhe trajtim të ndryshëm të individëve ose kategori personash që ndodhen në kushte të njëjta. Dënimi penal për personat juridikë rregullohet me ligj të posaçëm, masa e tij dhe kriteret e zbatueshme për caktimin e tij parashikohen në ligj. Paqartësia e pretenduar është e paqenë, pasi në gjykimin konkret të gjykatës referuese identifikohet lehtësisht se zbatohet shkronja “b” e pikës 4 të nenit 11 të ligjit nr. 9754/2007. Përcaktimi i marzheve të dënimit është në tagër të ligjvënës, bazuar në vlerësimin e tij për rrezikshmërinë e veprës penale dhe objektivat e shtetit në luftën kundër kriminalitetit.

9.3 Pretendimi për *cenimin e parimeve të ligjshmërisë, proporcionalitetit dhe drejtësisë në caktimin e dënimit penal* si jo në përputhje me nenet 4 dhe 17 të Kushtetutës, është i pabazuar. Dispozita e kundërshtuar individualizon qartë dënimin penal për personat juridikë. Qëllimi i ligjvënësit ka qenë referimi vetëm në maksimumin e dënimit me burgim të veprave të ndryshme. Gjykata referuese e ka nxjerrë nga kuptimi dhe i ka prishur logjikën dhe ekuilibrin ndërtimit të dispozitës. Ajo nuk ka dhënë asnjë arsye të shkeljes së ndonjë prej elementeve të proporcionalitetit. Dispozita i përgjigjet interesit publik për parandalimin e kriminalitetit të personave juridikë. Gjopa është ekuivalente e dënimit me burgim që zbatohet ndaj personave fizikë për veprat penale të caktuara.

9.4 Pretendimet për *cenimin e së drejtës së pronës dhe lirisë ekonomike*, sipas neneve 41 dhe 11 të Kushtetutës, nuk qëndrojnë. Gjopa është rrjedhojë e veprës penale të kryer nga personi juridik, në emër ose në dobi të tij.

10. **Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se:

10.1 Gjykata referuese *nuk legjitimohet*, pasi pavarësisht se ka identifikuar lidhjen e drejtpërdrejtë të normës ligjore të kundërshtuar me gjykimin pranë saj, si dhe ka sjellë arsye bindëse për antikushtetutshmërinë, ajo nuk ka bërë të gjitha përpjekjet për interpretimin e normës në përputhje me Kushtetutën. Situata në rastin konkret ka të bëjë me paqartësinë e normës dhe jo me mungesën e saj, ndaj gjykata referuese mund të bënte interpretim pajtues mes KP-së dhe ligjit të posaçëm.

10.2 Arsyetimi i gjykatës referuese për aplikimin e dispozitës favorizuese, në kuptim të nenit 3 të KP-së dhe cenimi i të drejtave të individit për shkak të *ometimit ligjor* është i gabuar dhe nuk qëndron. Ndonëse ometimi ligjor nuk mund të cenojë të drejtat e ligjshme të të gjykuarit konkret, ai mbetet një rrezik potencial për praktikën gjyqësore dhe, si i tillë, mbart detyrimin për Gjykatën për të urdhëruar Kuvendin për riformulimin e dispozitës.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e gjykatës referuese

11. Nenet 134, pika 1, shkronja “dh” dhe 145, pika 2, të Kushtetutës parashikojnë se Gjykata vihet në lëvizje me kërkesë të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, kur gjyqtarët gjatë gjykimit çmojnë se ligjet bien në kundërshtim me Kushtetutën. Në këtë rast ata nuk i zbatojnë ato, por pezullojnë gjykimin dhe ia dërgojnë çështjen Gjykatës.

12. Në rastin në shqyrtim, gjykata referuese ka pezulluar gjykimin dhe ka vendosur dërgimin e çështjes në Gjykatë, duke parashtruar se neni 11, pika 4, i ligjit nr. 9754/2007 bie ndesh me mosdënimin pa ligj, barazinë para ligjit, drejtësinë, ligjshmërinë, sigurinë juridike, pronën private dhe lirinë e veprimtarisë ekonomike, të drejta dhe parime të cilat garantohen respektivisht nga nenet 29, 17, 18, 4, 41 dhe 11 të Kushtetutës.

13. Subjektet e interesuara, Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, kanë kundërshtuar legjitimitimin e gjykatës referuese, duke parashtruar se: i) jo e gjithë dispozita e kundërshtuar lidhet me gjykimin që ajo po zhvillon; ii) gjykata referuese nuk ka bërë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar ligjin në përputhje me Kushtetutën; iii) argumentet e saj kanë të bëjnë me interpretimin e ligjit. Sipas tyre, gjykata referuese mund të zbatonte KP-në, si ligj i përgjithshëm që ka vepruar edhe përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9754/2007, si dhe të bazohej në praktikën gjyqësore shqiptare që nga viti 2007. Gjykata referuese nuk legjitimohet për antikushtetutshmërinë e ligjit në raport me normat e tjera të KP-së, të cilat nuk janë të zbatueshme në gjykimin pranë saj. Për më tepër, sipas tyre, shfuqizimi i gjithë dispozitës sjell automatikisht pasoja mbi vendimet gjyqësore në ekzekutim, duke shuar në mënyrë të padrejtë dënimet e dhëna.

14. Subjekti tjetër i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se gjykata referuese nuk legjitimohet, pasi nuk ka arritur të paraqesë argumente të mjaftueshme për pamundësinë e zgjidhjes së gjykimit prej saj. Po ashtu, ajo nuk ka bërë të gjitha përpjekjet për interpretimin e normës në përputhje me Kushtetutën. Gjkata referuese mund të bënte interpretim pajtues mes KP-së dhe ligjit të posaçëm për të saktësuar paqartësinë e normës, dhe nëse ka ometim ligjor, ai është rrezik potencial për praktikën gjyqësore, ndaj Gjykata ka detyrimin të urdhërojë Kuvendin për riformulimin e dispozitës.

15. Gjykata, paraprkisht, evidenton se edhe më herët asaj i është kërkuar, nëpërmjet kontrollit incidental, vlerësimi i kushtetutshmërisë së ligjit nr. 9754/2007, çështje në të cilën ajo ka vendosur rrëzimin e kërkesës (*shih vendimin nr. 38, datë 25.7.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Në atë rast Gjykata ka shqyrtuar pretendimet që lidheshin me cenimin e parimit të shtetit të së drejtës, të garantuar nga nenet 4, 16, pika 2, 29, pika 1 dhe 81, pika 2, shkronja “d”, të Kushtetutës, pra vetëm anën procedurale të miratimit të ligjit, pa analizuar përmbajtjen e dispozitave në raport me Kushtetutën. Në këtë situatë, Gjykata vlerëson se vendimi nr. 38, datë 25.7.2013 nuk përbën pengesë për shqyrtimin kushtetues të çështjes konkrete, sipas nenit 31/a, pika 2, shkronja “dh”, të ligjit nr. 8577/2000, sepse kërkesa në shqyrtim, ndonëse ka në objekt një dispozitë të ligjit nr. 9754/2007, në përmbajtje paraqet shkaqe të reja.

16. Gjykata ka zhvilluar disa kritere kumulative për legjitimimin e gjykatës referuese që vë në lëvizje kontrollin incidental të kushtetutshmërisë së normës ligjore bazuar në nenin 145 të Kushtetutës, të konkretizuar në nenin 68 të ligjit nr. 8577/2000. Sipas tyre, gjykata referuese duhet që gjatë gjykimit që zhvillohet pranë saj: i) të ketë identifikuar ligjin që do të zbatohet për zgjidhjen e tij dhe të ketë krijuar bindjen se gjykimi i saj nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga çështja në Gjykatë - pra lidhjen e drejtpërdrejtë midis ligjit dhe çështjes kushtetuese; ii) të ketë parashtruar arsye bindëse për antikushtetutshmërinë e ligjit, duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës; iii) të ketë bërë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar atë në përputhje me Kushtetutën (*shih vendimet nr. 7, datë 23.2.2021; nr. 1, datë 26.1.2021; nr. 8, datë 7.2.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

i) Për identifikimin e ligjit të zbatueshëm dhe lidhjen e drejtpërdrejtë

17. Lidhur me kriterin e parë të legjitimitit, Gjykata ripohon se gjykata referuese duhet të arsyetojë efektin e drejtpërdrejtë që ka dispozita e kundërshtuar për gjykimin pranë saj, duke individualizuar se pikërisht ajo dispozitë zbatohet dhe zgjidh mosmarrëveshjen konkrete pranë saj. Dispozita e kundërshtuar duhet të ketë lidhje me gjykimin në gjykatën referuese në atë masë që ai nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur pa u shqyrtuar nga Gjykata kushtetutshmëria e dispozitës ligjore (*shih vendimet nr. 30, datë 2.11.2022; nr. 1, datë 26.1.2021; nr. 30, datë 25.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Ndërsa, në lidhje me kriterin e arsyeve të rëndësishme të antikushtetutshmërisë, Gjykata rithekson se në vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjeve ajo niset nga prezumimi i pajtueshmërisë së tyre me Kushtetutën, që do të thotë se argumentet e parashtruara duhet të jenë bindëse, për t'i dhënë mundësi kësaj Gjykate të vlerësojë nëse zgjidhjet ligjore të zbatuara shkelin normat dhe vlerat kushtetuese (*shih vendimet nr. 30, datë 2.11.2022; nr. 5, datë 27.1.2017; nr. 52, datë 26.7.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, gjykata referuese duhet të bëjë të gjitha përpjekjet për të interpretuar dispozitën ligjore në përputhje me Kushtetutën dhe vetëm nëse vlerëson se të gjitha interpretimet e mundshme bien në kundërshtim me të, atëherë duhet t'i drejtohet Gjykatës duke kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së normës ligjore të identifikuar (*shih vendimin nr. 4, datë 23.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se gjykata referuese po shqyrton në shkallë të dytë ankimin e një personi juridik ndaj vendimit gjyqësor nr. 2485, datë 5.11.2020. Me anë të këtij vendimi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në zbatim të nenit 11, pika 4, shkronja “b”, e ka dënua personin juridik me gjobë në masën 6,000,000 lekë për veprën penale të shkeljes së rregullave të

mbrojtjes në punë, të parashikuar nga neni 289, paragrafi 1, i KP-së, si vepër e dënueshme me gjobë ose me burgim gjer në dhjetë vjet, ndërsa në zbatim të nenit 11, pika 4, shkronja “c”, e ka dënuar personin juridik me gjobë në masën 1,000,000 lekë për veprën penale të dhënies së ndihmës për ndërtim të paligjshëm, të parashikuar nga neni 199/b i KP-së (përpara ndryshimeve me ligjin nr. 146/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”), si vepër e dënueshme me burgim deri në 3 vjet. Në bashkim të dënimeve dhe në ulje me 1/3-ën, për shkak të gjykitimit të shkurtuar, personi juridik është dënuar nga gjykata e shkallës së parë përfundimisht me 4,000,000 lekë.

19. Gjykata konstaton se neni 45 i KP-së, në paragrafët e parë dhe të katërt, parashikon se personat juridikë, me përjashtim të institucioneve shtetërore, përgjigjen penalisht për vepra penale të kryera në emër ose në dobi të tyre nga organet dhe përfaqësuesit e tyre dhe veprat penale, masat ndëshkuese përkatëse, që zbatohen ndaj personave juridikë, si dhe procedura për vendosjen dhe ekzekutimin e tyre rregullohen me ligj të veçantë. Mbi bazën e këtij delegimi, Kuvendi, bazuar në nenet 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, ka miratuar ligjin nr. 9754/2007, i cili përcakton rregullat për përgjegjësinë, procedimin penal dhe llojet e masave ndëshkuese që merren ndaj personave juridikë për kryerjen e veprës penale. Sipas nenit 11, pika 1, të tij, dënimi me gjobë konsiston në pagimin, në favor të shtetit, të një shume të hollash, brenda kufijve të parashikuar në këtë ligj. Në varësi të llojit të veprës penale, kufijtë janë kategorizuar në tri hipoteza në pikën 4 të nenit 11, me referencë të dënimet me burgim të parashikuara në KP për veprat penale të kryera nga individët: (i) për krime që parashikohet një dënim, minimumi, jo më pak se 15 vjet burgim ose burgim i përjetshëm, personi juridik dënohet me gjobë nga 25 milionë lekë deri në 50 milionë lekë (*shkronja “a”*); (ii) për krime që parashikohet një dënim, minimumi, jo më pak se 7 vjet deri në 15 vjet burgim, personi juridik dënohet me gjobë nga 5 milionë lekë deri në 25 milionë lekë (*shkronja “b”*); (iii) për krime që parashikohet një dënim, maksimumi, më pak se 7 vjet, personi juridik dënohet me gjobë nga 500 mijë lekë deri në 5 milionë lekë (*shkronja “c”*). Ndërsa për kundërvajtjen penale kufijtë e dënimit me gjobë janë nga 300 mijë deri në 1 milion lekë (*pika 5 po aty*).

20. Çështja kushtetuese e parashtruar nga gjykata referuese lidhet me faktin se kufijtë e dënimit “*gjobë ose me burgim deri në 10 vjet*”, të parashikuar për individin nga neni 289, paragrafi 1 i KP-së për krimin “Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë”, nuk mund të klasifikohen në asnjë prej hipotezave të paragrafit 4 të nenit 11 të ligjit nr. 9754/2007, ndaj ajo nuk ka mundësi të kryejë interpretim pajtues të ligjit për t’i dhënë zgjidhje ankimit të personit juridik mbi masën e dënimit të caktuar nga gjykata e shkallës së parë. Gjykata referuese parashtron se nuk mund të zbatohet ligjin penal favorizues - pra shkronjën e nenit 11 me parashikim më të lehtë, pasi nuk janë kushtet e veprimit të ligjit në kohë të ndryshme. Sipas saj, neni 34 i KP-së nuk është i zbatueshëm në gjykimin pranë saj, sepse ai përbën normë të përgjithshme që disiplinon dënimin me gjobë dhe modalitetet e ekzekutimit të tij në rastin e individit, si person fizik, ndërsa dënimi me gjobë dhe modalitetet e tij në rastin e personit juridik rregullohen me ligjin e posaçëm (*lex specialis*) nr. 9754/2007.

21. Në pikën 2 të dispozitivit të vendimit të saj për dërgimin e çështjes në Gjykatë, gjykata referuese ka kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së nenit 11, pika 4, të ligjit nr. 9754/2007, ndërsa në pjesën arsyetuese ka analizuar paqartësinë e hartimit të tekstit të shkronjave “a”, “b” dhe “c” të kësaj pike referuar kriterit të përdorur. Konkretisht, në shkronjat “a” dhe “b”, kategorizimi i kufijve të dënimit është i qartë sepse si referencë e rëndësisë së rrezikshmërisë së veprës penale përdoret i njëjti kriter - “*minimumi i dënimit*” i parashikuar nga KP-ja për veprat penale, ndërsa në shkronjën “c” është përdorur kriteri “*maksimumi i dënimit*”. Në këtë mënyrë, edhe pse në gjykimin pranë saj zbatohen drejtpërdrejt vetëm shkronjat “b” dhe “c” të pikës 4 të nenit 11 të ligjit nr. 9754/2007, gjykata referuese parashtron se çështja kushtetuese lidhet me paqartësinë e të gjithë tekstit të nenit 4, përfshirë shkronjën “a”, për shkak të ndërldhjes që të tria hipotezat kanë në funksion të caktimit të masës së dënimit me gjobë.

22. Për sa i takon prapësimit të subjekteve të interesuara se gjykata referuese nuk legjitimohet për të kërkuar antikushtetutshmërinë e ligjit në formën e ometimit ligjor në raport me normat e tjera të KP-së, Gjkata konstaton se këto të fundit nuk janë të zbatueshme në gjykimin penal që po zhvillohet dhe se objekti i çështjes kushtetuese është përcaktuar lidhur vetëm me nenin 11, pika 4. Kjo do të thotë se parashtrimet e gjykatës referuese përtej kësaj dispozite shërbejnë si argumente të objektit të gjykimit kushtetues, ndaj nuk mund të shqyrtohen si kërtime të veçanta.

23. Për sa më lart, Gjkata çmon se gjykata referuese plotëson kriterin e parë të legjitimitetit për identifikimin e ligjit të zbatueshëm - nenit 11, pika 4, si dhe të lidhjes së drejtpërdrejtë të tij me gjykimin që ajo po zhvillon.

ii) Për parashtrimin e arsyeve serioze të antikushtetutshmërisë

24. Lidhur me kriterin e dytë të legjitimitetit, Gjkata evidenton fillimisht se neni 16, pika 2, i Kushtetutës garanton të drejtat, liritë themelore dhe detyrimet e parashikuara në të edhe për personat juridikë, për aq sa ato përputhen me qëllimet e përgjithshme të këtyre personave dhe me thelbin e këtyre të drejtave, lirive dhe detyrimeve. Në këtë këndvështrim, parimet dhe të drejtat themelore të parashtruara nga gjykata referuese (mosdënimi pa ligj, barazia para ligjit, drejtësia, ligjshmëria, siguria juridike, prona private dhe liria e veprimtarisë ekonomike), në thelb, janë të tilla që vlejnë edhe për personin juridik.

25. Për sa i takon këtij kriteri, në ndryshim nga sa prapësojnë subjektet e interesuara Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, Gjkata vlerëson se gjykata referuese e përmbush këtë kriter legjitimiteti. Argumentet e parashtruara prej saj për antikushtetutshmërinë e nenit 11, pika 4, të ligjit nr. 9754/2007, janë konkrete dhe lidhen me cenimin e disa parimeve themelore dhe të drejtave të njeriut, si pasojë e paqartësisë në formulimin e normës, ndaj janë të mjaftueshme në kontekstin e vlerësimit *prima facie* të legjitimitetit. Në këtë drejtim, Gjkata çmon se nuk qëndron edhe argumenti tjetër i subjekteve të interesuara, Kuvendit dhe Këshillit të Ministrave, se gjykata referuese nuk e përmbush kriterin e arsyeve bindëse të antikushtetutshmërisë, sepse nuk ka mbajtur në konsideratë praktikën gjyqësore, e cila e ka zbatuar dispozitën ligjore që prej vitit 2007. Ky prapësim është mbështetur vetëm në një rast ilustrues të vitit 2012, pa paraqitur të dhëna statistikore që të dëshmojnë praktikë gjyqësore të qëndrueshme ose vendime gjyqësore njëse apo zhvilluese mbi normën ligjore të kundërshtuar.

iii) Për të gjitha përpjekjet për interpretimin e ligjit në përputhje me Kushtetutën

26. Në analizën e kriterit të tretë legjitimiteti, që lidhet me të gjitha përpjekjet paraprake të gjykatës referuese për të interpretuar dispozitën ligjore në përputhje me Kushtetutën, Gjkata thekson se paraqitja e kërkesës për kontroll incidental të një norme ligjore duhet të konsiderohet si një instrument fundor nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, jo vetëm në zbatim të prezumimit të kushtetutshmërisë së ligjeve, por edhe duke konsideruar se një kontroll i tillë ndikon në kohëzgjatjen dhe të drejtat e palëve në gjykimin e zakonshëm.

27. Në rastin konkret, Gjkata, duke mbajtur parasysh se shkaqet e kërkesës lidhen me paqartësinë e normës penale, si dhe analizën e gjykatës referuese mbi pamundësinë e zbatimit të parimit të ligjit penal favorizues, vlerëson se ajo është përpjekur mjaftueshëm për interpretimin e normës në përputhje me Kushtetutën në funksion të zgjidhjes së gjykimit pranë saj, duke plotësuar këtë kriter legjitimiteti. Në këtë kontekst, Gjkata konsideron edhe faktin se aktet e hartuara gjatë *travaux préparatoires* të miratimit të ligjit nr. 9754/2007 nuk janë të aksesueshme publikisht, gjë që mund të lehtësonte njohjen me qëllimin e ligjvënësit dhe teknikat legislative të përdorura prej tij.

28. Në përmbledhje të arsyetimit të mësipërm, Gjkata çmon se gjykata referuese plotëson kriteret e legjitimitetit në kuptim të nenit 145, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 68 të ligjit nr. 8577/2000, ndaj në vijim do të kontrollojë themelin e pretendimeve lidhur me kushtetutshmërinë e pikës 4 të nenit 11 të ligjit nr. 9754/2007.

29. Në këtë drejtim, gjykata referuese ka parashtruar se caktimi i një dënimi të pabazuar qartë në ligj cenon të drejtën e mosdënimit pa ligj, të garantuar nga neni 29 i Kushtetutës, pasi dënimi penal duhet të jetë i drejtë dhe në përpjesëtim me veprën penale të kryer, në përputhje me nenin 17 po të Kushtetutës. Sipas saj, paqartësia e normës ligjore jo vetëm nuk respekton parimin e sigurisë juridike, por i ekspozon ndaj së njëjtës masë dënimi personat juridikë që kanë kryer vepra penale me rrezikshmëri të ndryshme, ndaj cenohet parimi i barazisë para ligjit dhe i drejtësisë i sanksionuar nga neni 18 i Kushtetutës. Po ashtu, ajo parashtron se caktimi i dënimit me gjobë passjell pasoja financiare dhe ekonomike për personin juridik, duke i cenuar në këtë mënyrë të drejtën e pronës private dhe lirinë e veprimtarisë ekonomike, të garantuara respektivisht nga nenet 41 dhe 11 të Kushtetutës.

30. Gjkata ka theksuar se kur kontrollohen aktet e pushtetit publik, sa herë që vihet në diskutim një e drejtë kushtetuese ose liri themelore, është me rëndësi të verifikohen parimet që lidhen me cilësinë e ligjit, parashikueshmërinë, sigurinë juridike dhe barazinë para ligjit, pasi janë pikërisht ato që mbrojnë individin nga arbitrariteti, veçanërisht në marrëdhëniet ndërmjet tij dhe shtetit (*shih vendimet nr. 39, datë 15.12.2022; nr. 30, datë 2.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Për rrjedhojë, referuar thelbit të argumenteve të kërkesës, Gjykata do t'i shqyrtojë pretendimet për cenimin e parimeve të drejtësisë, ligjshmërisë dhe sigurisë juridike, të lidhura me të drejtën kushtetuese të mosdënimit pa ligj, konkretisht si pjesë të aspektit substancial të cilësisë që duhet të ketë ligji. Në këtë pikë, Gjykata rithekson se ligji duhet jo vetëm të jetë i aksesueshëm për të interesuarin (në kuptim të marrjes dijeni) dhe i parashikueshëm për efektet e tij, por edhe mjaftueshmërisht i qartë, me qëllim që t'u japë individëve një tregues të përshtatshëm për rrethanat dhe kushtet në të cilat autoritetet publike janë të autorizuar të ndërhyjnë në të drejtat kushtetuese të tyre (*shih vendimin nr. 30, datë 2.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Ndërsa për sa i takon së drejtës së pronës dhe lirisë së veprimtarisë ekonomike, nga mënyra se si ato janë parashtruar nga gjykata referuese, Gjykata paraprakisht vëren se garantimi i tyre ndërvaret nga verifikimi i pretendimit të cenimit të së drejtës së mosdënimit pa ligj.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e së drejtës së mosdënimit pa ligj

32. Gjykata referuese ka parashtruar se mënyra se si janë shkruar klasifikimet e dënimit me gjobë për personat juridikë në dispozitën ligjore të kundërshtuar është e pasaktë. Për shkak të paqartësisë së saj mbetet në pikëpyetje fakti se cili do të jetë marzhi i dënimit me gjobë për personat juridikë që kanë kryer vepra penale të dënueshme sipas KP-së, në minimum, më pak se 7 vjet burgim dhe, në maksimum, më shumë se 7 vjet burgim. Për më tepër, në gjykimin që ajo po zhvillon, për shkak të kufijve të dënimit që parashikon neni 289, paragrafi 1, i KP-së, vepra penale e shkeljes së rregullave të mbrojtjes në punë nuk mund të klasifikohet as në shkronjën “b”, as në shkronjën “c” të pikës 4 të nenit 11 të ligjit nr. 9754/2007. Sipas saj, në rastin konkret nuk mund të zbatohet ligji penal favorizues, pra parashikimi ligjor për masën më të ulët të gjobës, sepse nuk janë kushtet e veprimit të ligjit në kohë të ndryshme.

33. Subjektet e interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Kuvendi, kanë prapësuar se baza e dënimit me burgim, me qëllim llogaritjen e masës së gjobës, është maksimumi i dënimit me burgim. Sipas tyre, norma e kundërshtuar nuk mund të interpretohet literalisht, por duhet përdorur rregulli interpretues “*presumimi i përdorimit të qëndrueshëm*”. Dispozita e kundërshtuar rregullon qartë mënyrën e individualizimit të dënimit për personat juridikë. Ajo është në harmoni me legjislacionin penal e kushtetues. Qëllimi i ligjvënësit nuk ka qenë referimi në dy kufijtë e dënimit me burgim (*në minimum dhe maksimum*), por vetëm në maksimumin e tij. Dispozita i përgjigjet interesit publik për parandalimin e kriminalitetit të personave juridikë. Formulimi i ndryshëm për kriteret e minimumit dhe maksimumit të dënimit në dispozitën e kundërshtuar në raport me atë të KP-së, nuk përbën

shkak antikushtetutshmërie. Paqartësia e pretenduar është detyrë për t'u rregulluar nga praktika gjyqësore.

34. Subjekti tjetër i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se parimi i ligjshmërisë nuk është cenuar në nivel kushtetues. Kur ligji është i paqartë, ai zbatohet në mënyrën më favorizuese për të pandehurin. Në rastin konkret për nenin 289, paragrafi 1, të KP-së është e zbatueshme shkronja “c” e pikës 4 të nenit 11 të ligjit nr. 9754/2007, si ligji më i favorshëm.

35. Neni 29 i Kushtetutës, që nga pikëpamja sistematike është përfshirë në pjesën e të drejtave themelore, në përmbajtjen e tij parashikon ndalimin e dënimit pa ligj, duke përcaktuar se askush nuk mund të akuzohet ose të deklarohet fajtor për një vepër penale, e cila nuk konsiderohet e tillë me ligj në kohën e kryerjes së saj, me përjashtim të veprave, të cilat në kohën e kryerjes së tyre, përbënin krime lufte ose krime kundër njerëzimit sipas së drejtës ndërkombëtare (*pika 1*); nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ka qenë parashikuar me ligj në kohën e kryerjes së veprës penale (*pika 2*); ligji penal favorizues ka fuqi prapavepruese (*pika 3*).

36. Gjykata është shprehur se e drejta për të mos u dënuar pa ligj (*nullum crimen nulla poena sine lege*) është një element thelbësor i shtetit të së drejtës. Ky parim duhet të interpretohet dhe zbatohet në mënyrë që të ofrojë garanci efektive kundër ndjekjes, deklarimit fajtor dhe dënimit arbitrar (*shih vendimet nr. 16, datë 15.6.2009; nr. 14, datë 17.4.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas këtij parimi, çdo vepër penale duhet të parashikohet me ligj dhe individit duhet të jetë objektivisht në gjendje, nëse është e nevojshme edhe me ndihmën e interpretimeve gjyqësore, të kuptojë përmbajtjen e normës penale, pra se çfarë veprimesh ose mosveprimesh do ta bëjnë atë përgjegjës penalisht. Kur bëhet fjalë për mundësinë e individit për të parashikuar pasojat e veprimeve të tij, nuk është e thënë që të nënkuptohet një qartësi absolute. Ligji duhet të jetë në gjendje të ndjekë rrethanat e ndryshme dhe, për këtë arsye, një standard i një parashikueshmërie të arsyeshme është i mjaftueshëm (*shih vendimin nr. 16, datë 15.6.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në jurisprudencën e saj mbi të drejtën e mosdënimit pa ligj, ka vënë në dukje se parimi që vetëm ligji mund ta përcaktojë krimin dhe të parashikojë masën e dënimit nënkupton që veprat penale dhe masat e dënimit për ndëshkimin e tyre duhet të jenë të përkufizuara qartësisht me ligj. Nocioni “*ligj*” nënkupton disa kushte cilësore, sidomos ato të mundësisë së qasjes dhe të parashikueshmërisë (*shih Cantoni k. Francës, § 29; Kafkaris k. Qipros [DhM], § 140; Del Río Prada k. Spanjës [DhM], § 91*). Këto kushte cilësore duhet të përmbushen si për përkufizimin e një veprë penale (*shih Jorgic k. Gjermanisë, §§ 103-114*), ashtu edhe për masën e dënimit që ajo nënkupton ose për shtrirjen e saj (*shih Kafkaris k. Qipros [DhM], § 150; Camilleri k. Maltës, §§ 39-45*).

38. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se KP-ja përbën ligjin më të rëndësishëm, ku përfshihen në mënyrë të sistemuar dispozitat penalo-juridike dhe se një nga parimet kryesore që përshkon këtë kod është edhe ai i ligjshmërisë, që nënkupton parashikimin me ligj të veprave penale dhe mosdënimin për një vepër penale që nuk është parashikuar shprehimisht si krim ose kundërvajtje penale (*shih vendimin nr. 38, datë 25.7.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Duke pasur parasysh rëndësinë që ka legjislacioni penal dhe sidomos efektin e dënimeve penale mbi të drejtat e njeriut, normat penale duhet të jenë të parashikueshme dhe të qarta. Standardet për saktësinë e ligjit janë të rëndësishme për ligjin penal, pasi krijojnë lidhje të drejtpërdrejtë me dy prej parimeve kryesore të së drejtës penale, siç janë parimi i ligjshmërisë (mosdënimi penalisht për vepra që nuk parashikohen shprehimisht në ligj) dhe ndalimi i zbatimit të ligjit penal me analogji (*shih vendimet nr. 39, datë 15.12.2022; nr. 24, datë 4.5.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

39. Në këtë drejtim, Gjykata, duke mbajtur parasysh parimin e ndarjes së pushteteve, rritet se përcaktimi i veprave penale, llojeve dhe masave të dënimeve është në diskrecion të ligjvënësit, ndërsa individualizimi i tyre në raste konkrete është në diskrecion të gjykatës, e cila duke shqyrtuar të gjitha elementet juridike të veprës penale, shkallën e fajit dhe pasojat e ardhura nga vepra penale, cakton

llojin dhe masën e dënimit për autorët e veprave penale (*shih vendimin nr. 47, datë 26.7.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

40. Për sa më lart, Gjykata çmon se neni 29 i Kushtetutës, duke ndaluar dënimin pa ligj, synon të garantojë që çdo individ ta përshtatë sjelljen e tij sipas legjislacionit penal dhe të mos gjendet përpara kundërveprimeve shtetërore të paparashikueshme. Në kushtet kur dënimet penale ndërhyjnë drejtpërdrejt te liritë dhe të drejtat themelore, neni 29 ia ka ngarkuar vetëm ligjvënësit miratimin abstrakt të veprave dhe dënimeve penale, i cili ka detyrimin të përshkruajë me saktësi jo vetëm elementet e figurës së veprës penale, por edhe llojin dhe masën e dënimit të saj, pra kufijtë e dënimit. Në këtë kuptim, ligjvënësi është i detyruar nga Kushtetuta të caktojë kufijtë e dënimit penal, duke respektuar kërkesat e qartësisë dhe përcaktueshmërisë së ligjit sipas parimit të sigurisë juridike, rigoroziteti i të cilave rritet në raport të drejtë me ashpërsinë e ndërhyrjes. Ligjvënësi e plotëson detyrimin e tij, nëse ai gjatë zgjedhjes së dënimit e orienton saktë dhe qartë si gjyqtarin penal, ashtu edhe individin e prekur, në mënyrë që autori i veprës penale të jetë në gjendje të parashikojë masën e dënimit që i kanoset, ndërsa gjyqtari penal të ketë mundësi të individualizojë masën e përshtatshme të dënimit.

41. Në vijim, Gjykata evidenton se nga parimi i sigurisë juridike, i cili në procesin penal është i lidhur me parimin e ligshmërisë, merr rëndësi që normat ligjore të jenë të parashikueshme, të qarta, të sakta dhe të kuptueshme. Megjithatë, ashtu siç është pohuar në jurisprudencën kushtetuese, në parim është e pamundur që normat të hartohen në mënyrë të tillë që të parashikojnë çdo rast praktik të së ardhmes, ndaj mbetet detyrë kryesore e organeve ligjzbatuese, ku përfshihen edhe gjykatat, që kuptimin e ligjit ta plotësojnë natyrshëm gjatë zbatimit praktik të tij, duke përdorur metoda të qëndrueshme interpretimi (*shih vendimin nr. 34, datë 20.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

42. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, nën dritën e standardeve të mësipërme, Gjykata vëren se nga pikëpamja strukturore, pika 4 e nenit 11 të ligjit nr. 9754/2007 i kategorizon masat e dënimit penal me gjobë për personat juridikë në tre nënpika “a”, “b” dhe “c”, sipas dënimeve me burgim të parashikuara nga KP-ja për individët. Shkronja “a” parashikon masa gjobe nga 25 milionë në 50 milionë lekë për krime për të cilat dënimi në KP, *minimumi*, është jo më pak se 15 vjet burgim ose burgim të përjetshëm; shkronja “b” parashikon masa gjobe nga 5 milionë deri në 25 milionë lekë për krime për të cilat dënimi në KP, *minimumi*, është jo më pak se 7 vjet deri në 15 vjet burgim; shkronja “c” parashikon masa gjobe nga 500 mijë deri në 5 milionë lekë për krime për të cilat dënimi në KP, *maksimumi*, është më pak se 7 vjet burgim. Nga leximi literal i saj konstatohet se në shkronjat “a” dhe “b” është përdorur referenca “*minimum*”, ndërsa në shkronjën “c” është përdorur referenca “*maksimum*”, edhe pse objekti dhe synimi i rregullimit të paragrafëve të normës është i përbashkët - përcaktimi i kufijve të masave të dënimit me gjobë për personat juridikë në mënyrë të përshkallëzuar për t’iu përgjigjur parimit të proporcionalitetit sipas llojit të krimit. Po kështu, vihet re se referencat “*minimum*” dhe “*maksimum*” respektivisht në shkronjat “b” dhe “c” janë shoqëruar edhe me ndajfoljet sasiore “*jo më pak*” dhe “*më pak*” të dënimeve me burgim të veprave penale në KP.

43. Për sa më lart, Gjykata konstaton se në dukje pika 4 e nenit 11, në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, e ligjit nr. 9754/2007, ka një lloj paqartësie gjuhësore, e cila gjithsesi është e lidhur me teknikën legjislative të përdorur. Në këtë pikë duhet evidentuar se subjektet e interesuara, Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, kanë parashtruar se kriteret “*minimum*” dhe “*maksimum*” nuk kanë të njëjtin kuptim me atë të përdorur nga KP-ja, por janë referenca të kufirit maksimal të dënimit me burgim të parashikuar për çdo vepër penale në këtë kod. Ky prapësim nuk duket i paarsyeshëm, megjithatë Gjykata, duke respektuar kufijtë ndarës të juridiksionit kushtetues me atë gjyqësor, çmon se është detyrë kushtetuese e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të interpretojnë drejt ligjin gjatë zbatimit të tij në praktikë në zgjidhjen e çështjes konkrete.

44. Duke iu referuar formulimit sistematik të pikës 4, Gjykata vëren se ai ka përshkallëzuar me rend zbritës masat e dënimit penal me gjobë për personat juridikë, nga ato më të rëndat tek më të

lehtat. I njëjti rend zbritës përshkon edhe referencat në kufijtë e dënimeve penale të veprave sipas KP-së. Po ashtu, lidhur me këto referenca të KP-së, nuk konstatohet të ketë shpëputje me pasojë pasaktësi ose boshllëk ligjor, pasi shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të lexuara së bashku, mbulojnë të dyja llojet e dënimit (dënimin me burgim dhe dënimin me burgim të përjetshëm), si dhe të gjithë segmentin e dënimit me burgim nga 5 ditë deri në 35 vjet të ndarë në tri klasa me kufij të lidhur rrjedhshëm me njëri-tjetrin: a) të paktën 15 vjet ose burgim i përjetshëm; b) të paktën 7 vjet deri në 15 vjet; c) deri në 7 vjet burgim.

45. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se, në thelb, nuk rezulton që përmbajtja e pikës 4 të nenit 11 të ketë pasaktësi ose boshllëk ligjor. Paqartësitë referenciale të saj janë të tilla që nuk krijojnë kontradiksion logjik ose pamundësi zbatimi, që do të thotë se paqartësitë gjuhësore nuk kanë rëndësi të tillë kushtetuese që të passjellin papajtueshmërinë e normës me Kushtetutën. Këto paqartësi mund dhe duhet të zgjidhen me anë të interpretimit gjyqësor nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në ushtrim të rolit dhe funksionit të tyre kushtetues të interpretimit dhe zbatimit të ligjit.

46. Për sa më lart, Gjykata çmon se pika 4 e nenit 11, në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, e ligjit nr. 9754/2007 nuk rezulton të mos përmbushë aspektin substancial të cilësisë së ligjit, ndaj pretendimet për cenimin e së drejtës kushtetuese të mosdënimit pa ligj dhe parimeve të proporcionalitetit, të drejtësisë, të ligjshmërisë, të sigurisë juridike dhe të barazisë përpara ligjit janë të pabazuara.

47. Si rrjedhojë e kësaj pabazueshmërie, Gjykata vlerëson se edhe pretendimet e ndërvarura, sikurse cenimi i së drejtës së pronës private dhe lirisë së veprimtarisë ekonomike, janë të pabazuara.

48. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkesa e gjykatës referuese sipas arsyetimit të mësipërm është e pabazuar, ndaj duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “a” dhe 134, pika 1, shkronja “dh”, të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 30.5.2023.

Shpallur më 27.6.2023.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Elsa Toska, Fiona Papajorgji, Ilir Toska, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari, Marjana Semini, Genti Ibrahim

MENDIM PARALEL

1. Në çështjen me kërkuese Gjykatën e Apelit Tiranë dhe objekt: “*Shfuqizimi i nenit 11, pika 4, të ligjit nr. 9754, datë 14.6.2007, Për përgjegjësinë penale të personave juridikë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*”, nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën lidhur me argumentet mbi të cilat mbështetet rrëzimi i kërkesës, ndaj e çmojmë të rëndësishme të shprehemi me mendim paralel.

2. Shumica ka argumentuar: “Në rastin konkret, Gjykata, duke mbajtur parasysh se shkaqet e kërkesës lidhen me paqartësinë e normës penale, si dhe analizën e gjykatës referuese mbi pamundësinë e zbatimit të parimit të ligjit penal favorizues, vlerëson se ajo është përpjekur mjaftueshëm për interpretimin e normës në përputhje me Kushtetutën në funksion të zgjidhjes së gjykimit pranë saj, duke plotësuar këtë kriter legjitimimi [...]” (*shih paragrafin 27 të vendimit*).

3. Fillimisht, duam të theksojmë se jemi dakord me shumicën për evidentimin e kriterëve të legjitimitetit referuar jurisprudencës ndër vite të gjykatës, por ndahemi për analizën e këtyre kriterëve në kontekstin e rrethanave konkrete. Ndryshe nga shumica, vlerësojmë se në rastin në shqyrtim gjykata referuese nuk duhej të legjitimohej, pasi nuk plotësonte kriterin sipas të cilit ajo duhet të bënte *të gjitha përpjekjet* për ta interpretuar normën në përputhje me Kushtetutën. Po në këtë drejtim, në vlerësimin tonë, çështja, si rregull, nuk plotësonte as kriteret për kalimin e saj në seancë plenare.

4. Konkretisht, për legjitimitimin e gjykatës referuese që vë në lëvizje kontrollin incidental të kushtetutshmërisë së normës ligjore, bazuar në nenin 145 të Kushtetutës, të konkretizuar në nenin 68 të ligjit nr. 8577/2000, gjykata referuese duhet që gjatë gjykimit që zhvillohet pranë saj: i) të ketë identifikuar ligjin që do të zbatohet për zgjidhjen e tij dhe të ketë krijuar bindjen se gjykimi i saj nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga çështja në Gjykatën Kushtetuese – pra lidhjen e drejtpërdrejtë midis ligjit dhe çështjes kushtetuese; ii) të ketë parashtruar arsye bindëse për antikushtetutshmërinë e ligjit, duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës; iii) të ketë bërë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar atë në përputhje me Kushtetutën (*shih vendimet nr. 7, datë 23.2.2021; nr. 1, datë 26.1.2021; nr. 8, datë 7.2.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Në vështrim të kriterit për realizimin e të gjitha përpjekjeve për interpretim pajtues të normës, gjykata referuese ka argumentuar se nuk ka kurrfarë mundësie të kryhet një interpretim pajtues i ligjit (*shih paragrafin 17 të vendimit të gjykatës referuese*).

6. Në lidhje me kushtetutshmërinë e ligjeve, Gjykata niset nga prezumimi i kushtetutshmërisë së tyre me Kushtetutën, si dhe mundësia e interpretimit pajtues të tyre. Interpretimi pajtues është i mundur kur një ligj ose dispozitë ligjore mund të interpretohet në më shumë se një mënyrë, njëra nga të cilat është në pajtim me Kushtetutën. Kjo metodë kërkon efektet kushtetuese të rezultateve të ndryshme dhe përzgjedh rezultatin që është në pajtim me vlerat kushtetuese, duke marrë parasysh këtu të drejtat themelore të individëve (*shih vendimet nr. 5, datë 16.2.2012; nr. 33, datë 24.6.2010; nr. 29, datë 31.5.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata niset nga premisa që një akt normativ duhet të interpretohet në kuptimin që lejon zbatimin e tij, jo në atë që e përjashton këtë zbatim (*actus interpretandus est potius ut valeat quam ut pereat*) (*shih vendimin nr. 7, datë 24.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Interpretimet pajtuese, si teknikë interpretative, Gjykata, gjatë jurisprudencës së saj, i ka përdorur edhe në rastet kur para saj janë kundërshtuar ligjet e fushës penale (*shih vendimet nr. 37, datë 19.9.2011; nr. 26, datë 13.6.2011; nr. 30, datë 17.6.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Nisur nga standardet e sipërcituara, qëndrimi i gjykatës referuese bie ndesh me jurisprudencën e Gjykatës, pasi nga ajo nuk është argumentuar se sa mënyra interpretimi kishte dispozita, cila prej tyre sillte pasoja antikushtetuese, dhe nëse të gjitha interpretimet e mundshme nuk e shmangnin dot antikushtetutshmërinë e dispozitës. Kjo lloj analize e munguar është zëvendësuar përmes analizës së shumicës, e cila, pasi ka bërë disa lloj interpretimesh, gjuhësor/literal, sistematik e qëllimor, ka arritur në konkluzionin se ligji ka mundësi të interpretohet nga gjykata referuese në mënyrë pajtuese me Kushtetutën, edhe pse jo e artikuluar drejtpërdrejt prej saj (*shih paragrafët 42–45 të vendimit*). Shumica specifikisht ka arsyetuar: “Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se, në thelb, nuk rezulton që përmbajtja e pikës 4 të nenit 11 të ketë pasaktësi ose boshllëk ligjor. Paqartësitë referenciale të saj janë të tilla që në thelb nuk krijojnë kontradiksion logjik ose pamundësi zbatimi, që do të thotë se paqartësitë gjuhësore nuk kanë rëndësi të tillë kushtetuese që të pasjellin papajtueshmërinë e normës me Kushtetutën. Këto paqartësi mund dhe duhet të zgjidhen me anë të interpretimit gjyqësor nga

gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në ushtrim të rolit dhe funksionit të tyre kushtetues të interpretimit dhe zbatimit të ligjit.” (*shih paragrafin 45 të vendimit*).

8. Për sa më lart, duhej që sipas standardeve kushtetuese, jo Gjykata, por gjykata referuese të zgjidhte dyshimet interpretative, duke i dhënë normës së zbatueshme një interpretim që përputhet me parimet kushtetuese. Sipas Gjykatës, gjyqtari referues është i detyruar të zbatojë, midis interpretimeve të ndryshme të mundshme, atë që konsiderohet se përputhet me parimin kushtetues, që në të kundërt do të cenohej (*shih vendimet nr. 71, datë 27.11.2015; nr. 55, datë 21.7.2015; nr. 13, datë 16.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo gjykatë e kishte për detyrë të analizonte dispozitën objekt kundërshtimi, si funksion primar i saj, edhe për shkak të detyrimeve jurisprudenciale të Gjykatës, sipas së cilës, interpretimi i ligjeve është kompetencë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 4, datë 23.1.2017; nr. 22, datë 11.4.2016; nr. 29, datë 30.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Ashtu sikundër është shprehur edhe GJEDNJ-ja lidhur me kriterin e parashikueshmërisë së ligjit, për sa i përket nenit 7 të KEDNJ-së, (mosdënimi pa ligj), sado e qartë të jetë një dispozitë ligjore, në çdo sistem ligjor, përfshirë edhe atë penal, ekziston një element i pashmangshëm i interpretimit gjyqësor. Gjithmonë do të ketë nevojë për sqarim të pikave të dyshimta dhe përshtatje me ndryshimin e rrethanave. Zhvillimi progresiv i ligjit penal nëpërmjet praktikës gjyqësore është një pjesë e ngulitur mirë dhe e domosdoshme e traditës juridike në shtetet e Konventës. Neni 7 i Konventës nuk mund të lexohet në mënyrë të tillë që nuk lejon sqarimin gradual të rregullave të përgjegjësisë penale përmes interpretimit gjyqësor nga çështja në çështje, me kusht që zhvillimi interpretativ të jetë në përputhje me thelbin e veprës dhe të mund të parashikohet në mënyrë të arsyeshme Prandaj, pyetja mbi shkeljen e supozuar të këtij neni, duhet të shqyrtohet në bazë të formulimit jo vetëm të dispozitave në fjalë, por edhe të praktikës gjyqësore përkatëse (*shih Del Río Prada kundër Spanjës, §§ 92-93; Vasiliasukas kundër Lituanisë, § 155*).

10. Për rrjedhojë, vlerësojmë se shumica në rastin konkret edhe pse ka konfirmuar që nuk ka paqartësi të nivelit kushtetues dhe ka pranuar se norma mund të interpretohet nga vetë gjykata, në vend që ta rrëzonte për mungesë legjitimitimi, e ka rrëzuar në themel kërkesën, pasi ka realizuar ajo vetë interpretimin gjuhësor, sistematik e qëllimor, duke krijuar kështu edhe mbivendosje juridiksionesh mes atij kushtetues, si dhe gjyqësorit të zakonshëm. Kjo mospërputhje me linjën e argumenteve, në vlerësimin tonë passjellë kapërcim të kriterëve të legjitimitimit në mënyrë artificiale dhe konfuzion mbi zbatimin e tyre nga gjykatat referuese edhe për të ardhmen për ushtrimin e së drejtës për kontroll incidental, pasi kriteri “duhet të ketë bërë të gjitha përpjekjet për interpretim pajtues” është devijuar si standard në “të bëjë përpjekje të mjaftueshme për interpretim pajtues”, duke e lënë evazive dhe të paqartë se mbi çfarë parametrash i mat përpjekjet e mjaftueshme kjo gjykatë gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës.

11. Gjithashtu, theksojmë se kur norma ligjore vepron ndër vite dhe jep efekte që prezumohen kushtetuese, sikurse dhe në rastin konkret që ligji vepron që nga viti 2007, gjykata referuese do të duhej jo vetëm të bënte të gjitha përpjekjet për interpretimin e saj në mënyrë pajtuese, por ndërkohë të forconte argumentet e vëna në dispozicion të Gjykatës lidhur me llojet e interpretimit të saj ndër vite nga praktika gjyqësore, në vështrim historik, me qëllim kalimin e testit kushtetues të legjitimitimit. Vështrimi jurisprudencial historik merr rëndësi të veçantë, sidomos në rastet e kontrollit incidental të një norme ligjore. Kjo pasi, në vlerësimin sipas standardeve kushtetuese dhe konventore të qartësisë dhe cilësisë së ligjit, pavarësisht paqartësive që mund të lindin nga interpretimi literal i një dispozite ligjore, cilësia e ligjit nuk përbën gjithmonë shkak për shfuqizim, pasi përmbajtja e tij mund të lexohet në dritën e interpretimit të kryer nga praktika gjyqësore. Kur formulimi i një dispozite nuk është mjaft i qartë dhe krijon pasiguri e paqartësi, duhet të shqyrtohet nëse kuptimi i kësaj dispozite është sqaruar ose mund të sqarohet përmes interpretimit nga autoritetet gjyqësore. Gjatë interpretimit të normës ligjore, për gjykatat duhet të ketë rëndësi më tepër të mbrohet ligji se sa të shfuqizohet pjesërisht ose tërësisht, pasi duke eliminuar një akt legjislativ, që tërësisht ose pjesërisht

mund të shpëtohet, krijohen boshllëqe normative, të tilla që cenojnë interesa parësorë të mbrojtur nga Kushtetuta, si stabiliteti juridik, ligjshmëria, shteti i së drejtës, eficienta e praktikës gjyqësore, etj.

12. Për të gjitha sa më lart, kërkesa duhej rrëzuar për një nga kriteret jurisprudenciale mbi legjitimitimin, sipas së cilës, nëse gjykata referuese nuk ka bërë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar normën/ligjin objekt kundërshtimi në përputhje me Kushtetutën, ajo nuk legjitimohet.

Anëtare: Elsa Toska, Sonila Bejtja